

DEMOKRACIA NË VEPRIM STATUTI

Neni 1 DEFINICIONET

- (1) Demokracia në Veprim është emri i koalicionit të OJQ-ve Kosovare për vëzhgim të zgjedhjeve.
- (2) Akronimi i Demokracisë në Veprim në gjuhën Angleze është DiA, në gjuhën Shqipe DnV, si dhe DuA në gjuhën Serbe.
- (3) Anëtarët aktual të koalicionit janë nënshkrues të statutit

Neni 2 ANËTARËT

- (1) Anëtarët e pranueshëm të koalicionit janë organizata vëzhguese të cilat janë:
 - Jo-qeveritare
 - Jo-profitabile
 - Jo-partiake
 - Të regjistruara
- (2) Demokracia në Veprim është e hapur për anëtarët e rinj.
- (3) Për të aplikuar, anëtarët e rinj duhen të kenë së paku tri rekomandime nga anëtarët e DnV-së.
- (4) Anëtarët e rinj pranohen nga DnV me 2/3 e votave të anëtarëve të bordit të DnV-së.
- (5) Anëtarët mund të largohen ose suspendohen nga DnV nga më shumë së 2/3 e votave të anëtarëve të bordit .

Neni 3 LLOJET E ANËTARËVE

- (1) Demokracia në Veprim ka dy lloje të anëtarëve : anëtarët dhe anëtarët pa të drejtë vote.
- (2) Anëtarët pa të drejtë vote, nuk mund të votojnë në mbledhjet e bordit të DnV-së, dhe nuk kanë të drejtë të zgjidhen në Sekretariat. Këta anëtarë mund të përfaqësohen në misionet e DnV-së me kuotë të reduktuar. Ata kanë të drejtë të marrin pjesë në mbledhjet e bordit të DnV-së, por jo edhe të votojnë.
- (3) Kur një organizatë e re pranohet në koalicion, ajo bëhet anëtare pa të drejtë vote, dhe mund të aplikojë për anëtarësi të plotë pas dy viteve nga pranimi i saj në koalicion.

- (4) Bordi vendos nëse ajo organizatë mund të gëzojë anëtarësi të plotë me 2/3 e shumicës së anëtarëve.

Neni 4 **PARIMET E PUNËS**

- (1) DnV si organ jo formal i bazuar në parimet e listuara më poshtë:
- Shmangja nga konvikti i interesit
 - Transparenca
 - Mundësitë e barabarta për anëtarët

Neni 5 **SISTEMI I PROTOKOLLIT**

- (1) Një marrëveshje e veçantë e DnV-së bëhet Protokoll kur nënshkruhet nga më shumë se 1/3 e anëtarëve. Nënshkruarit e një Protokollit të DnV-së janë të obliguar të përmbushin detyrimet dhe përgjegjësitë që ai Protokoll kërkon.
- (2) Anëtarët kanë të drejtë që individualisht të vendosin ta nënshkruajnë një Protokoll ose jo. Kur një Protokoll në mënyrë specifike e cekë që ai duhet të nënshkruhet nga anëtarët e DnV-së, atëherë është obligative.

Neni 6 **ORGANET E DNV-SË**

- (1) DnV përbehet nga dy organe: Bordit të Drejtorëve dhe Sekretariatit.
- (2) Nëse është e domosdoshme, Bordi i Drejtorëve mund të krijoj organe shtesë siç janë: komisionet dhe klubet për të lehtësuar funksionimin e DnV-së.
- (3) Anëtarët e DnV-së mund të krijojnë struktura ad-hoc për projekte apo aktivitete të veçanta.

Neni 7 **BORDI I DREJTORËVE**

- (1) Bordi i Drejtorëve të DnV-së përbehet nga të gjitha organizatat anëtare. Anëtarët përfaqësohen në bord përmes Drejtorëve Ekzekutiv apo të deleguarve të tyre.
- (2) Bordi i Drejtorëve takohet së paku një herë në vit.
- (3) Dy të tretat (2/3) e anëtarëve duhen të jenë prezent në mënyrë që të ndodhë takimi i Bordit të Drejtorëve. Anëtarët pa të drejtë vote nuk konsiderohen pjesë e kuorunit.
- (4) Vendimet merren me mbi 50% plus një e numrit të anëtarëve prezent në takim.
- (5) Modifikimet në Protokollin e DnV-së miratohen me votën e 2/3 të anëtarëve.

(6) Bordi i Drejtorëve:

- Pranon anëtarët e rinj
- Mbikëqyr implementimin e Protokolleve të DnV-së
- Paraqet dhe ndryshon urdhëresat dhe Protokollet Kushtetuese
- Voton dokumente dhe iniciativa
- Përfundon anëtar
- Zgjedh Sekretariatit dhe drejton aktivitetet e tij
- Përcakton objektivat dhe qëllimet

Neni 8 **E DREJTA E VOTËS**

(1) Secili anëtar ka një votë.

(2) Anëtarët pa të drejtë vote nuk mund të votojnë në Bordin e Drejtorëve.

Neni 9 **GJUHA ZYRTARE E DNV-SË**

(1) Gjuha zyrtare e DnV-së është Shqip dhe Serbisht, ndërsa gjuha Angleze përdoret për të komunikuar me donatorët. Të gjitha takimet dhe dokumentet zyrtare të DnV-së do të jenë në gjuhën Shqipe dhe Serbe. Përfundime bëhen në raste të projekteve ndërkombëtare.

Neni 10 **SEKRETARIATI**

(1) Sekretariati caktohet nga Bordi i Drejtorëve dhe mund të përbëhet nga stafi i rekrutuar jashtë rrjetit ose nga anëtarët e organizatave të rrjetit nëse ato kanë staf për të ofruar.

(2) Sekretariati është fasilitues i aktiviteteve të DnV-së

(3) Dokumentet e përdorura për korrespondencë zyrtare nënshkruhen nga Sekretari.

(4) Përgjegjësit kryesorë të Sekretariatit janë:

- Përzgjedhja e vëzhguesve afat-gjatë në bashkëpunim me organizatat në rajon
- Fasilitimi dhe prezantimi i projekteve dhe aktiviteteve të DnV-së.
- Shpërndarja e informatave dhe komunikimi në mes të anëtarëve.
- Menaxhimi i aktiviteteve administrative të DnV-së
- Menaxhimi dhe bartja e projekteve të DnV-së
- Organizmi i takimeve vjetore të bordit të drejtorëve
- Mban kontakt dhe komunikon me organizatat ndërkombëtare si: UN, UNICEF, OSCE, Këshilli i Evropës, përfaqësuesit diplomatik OJQ-të ndërkombëtare konform rregulloreve dhe urdhëresave kushtetuese.
- Raportimi tek koalicioni 4 herë në vit, dhe raportet finale për bordin e drejtorëve.

(5) Sekretariati emërohet për mandat tre-vjeçar me mundësi të zgjatjes.